



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 5770/2 Prot.

Tiranë, më 29.08.2022

**Të dhëna mbi Vendimin**

**Nr. 115, datë 29.08 2022**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Qamil Doka" p.f., me NUIS L81924026A, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e kontratës Nr. 638 Prot., datë 14.04.2022 me objekt: "*Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave (blerje materiale)*", me vlerë 392.280 lekë (me TVSH), të lidhur me Universitetin e Sporteve të Tiranës.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23 të LPP.

**Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa):** "Qamil Doka" p.f., me NUIS L81924026A, me adresë: Rruga "Ali Demi", Kompleksi Matrix, Tregu Elektrik, Dyqani Nr. 1, Tiranë.

**I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:**

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Qamil Doka" P.F., ka nisur për mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike.

**II. Gjetjet:**

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP, në të cilin përcaktohet se: "*1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërmbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik*".

**III. Masat:**

Me Vendimin Nr. 115 datë 29.08.2022, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Qamil Doka" p.f., me NUIS L81924026A, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.